



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 449/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, Kryesues, Nenad Laziq dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Armend Ibrahimimi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Armend Ibrahimimi kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014 në ora 15:00 ka pranuar një ankesë nga Armend Ibrahimimi kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, në të cilën ankesë pretendon se në procesin e rinumërimit të votave në 439 vendvotime votat e tija janë rritur dukshëm. Sipas parashtruesit të ankesës në publikimin e rezultateve të pjesshme jo zyrtare, në media ai pohon se ka pasur 5057 vota ndërsa pas përfundimit të procesit të rinumërimit ai ka 6624 vota gjithsej. Ai pretendon që shkelja është bërë nga komisionerët nëpër qendrat e votimit QV, të cilat kanë manipuluar duke përcjellë rezultatet të paqena. Më tutje parashtruesi i ankesës pohon se ka informacione për manipulime nga shumë dëshmitarë, të cilët ishin pjesë e procesit, por për shkaqe sigurie ngurrojnë të dëshmojnë. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha kutitë, pasi që baza ligjore dhe faktet gjenden në QNR.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës gjeti se :

- **ankesa është e pabazuar**



PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk e ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Për me tepër, sipas ankuesit KQZ, me rastin e rinumërimit të votave në kutit e vendvotimeve të lartpërmendura ka korrigjuar gabimin në numërim, dhe me atë rast ankuesit votat e gjetura në ato kuti i janë llogaritur në rezultatin final të zgjedhjeve, gjë që tani sipas PZAP-it, nuk do të thotë patjetër se edhe në të gjitha vendvotimet tjera në Kosovë fletëvotimet e ankuesit janë keq numëruar, sepse për këtë ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka propozuar asnjë dëshmitar me të cilat dëshmi me bazë do të vihej në dyshim numërimi i saktë i të gjitha fletëvotimeve në Kosovë përkitazi me ankuesin.

Prandaj PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmimeve konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën në fjalë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.449/2014 më datën 30.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**


Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*